



UNMIK/REG/2001/37
22 dhjetor 2001

RREGULLORE NR. 2001/37

**PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË KONSOLIDUAR TË KOSOVËS DHE
AUTORIZIMIN E SHPENZIMEVE PËR PERIUdhËN PREJ 1 JANARIT DERI MË
31 DHJETOR 2002**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në përputhje me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren nr. 1999/1 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) të datës 25 korrik 1999, të ndryshuar, mbi Autoritetin e Administratës së Përkohshme në Kosovë dhe Rregulloren nr. 2000/16 të datës 6 nëntor 1999, të ndryshuar, mbi themelimin e Autoritetit Qendror Fiskal dhe çështje të tjera lidhur me të,

Duke marrë parasysh faktin se institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes nuk janë ende në gjendje të japin këshilla lidhur me këtë çështje dhe se Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm do t'i marrë parasysh mendimet e tyre kur t'ia komunikojnë atij,

Me qëllim të miratimit të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës për periudhën prej 1 janarit deri më 31 dhjetor 2002 dhe çështje të tjera lidhur me të,

Shpall sa vijon:

Neni 1
Përkufizime

Sipas kësaj Rregulloreje:

(a) Me “Kuvend” nënkuptojmë Kuvendin e Kosovës të themeluar në përputhje me kapitullin 9 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/9 të datës 15 maj 2001 për një Kornizë Kushtetuese të Vetëqeverisjes së Përkohshme në Kosovë;

(b) Me “linjë buxheti” nënkuptojmë shumën e përgjithshme të kategorive të shpenzimeve për institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes të themeluara në përputhje me

Rregulloren e UNMIK-ut 2001/9 (IPVK) dhe çfarëdo organi apo agjencie të tyre, organet apo agjencitë e Administratës së Përkohshme të UNMIK-ut që i ushtrojnë funksionet e tyre nën autoritetin dhe përgjegjësitë e rezervuara për Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm në përputhje me kapitullin 8 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/9, komunat dhe çdo organ apo agjenci të tyre dhe çfarëdo organesh apo zyre të pavarura të përmendura në kapitullin 11 të Rregulores së UNMIK-ut nr. 2001/9, siç është përcaktuar në tabelat e kësaj Rregulloreje;

(c) Me “Mbajtje të llogarive të Autoritetit Qendror Fiskal” nënkuptojmë mbajtjen e llogarive të përcaktuara nga Autoriteti Qendror Fiskal;

(ç) Me “detyrime” nënkuptojmë shpenzimet e parashikuara, pavarësisht se a i nënshtrohen apo nuk i nënshtrohen ato detyrimit ligjor;

(d) Me “kategoritë e shpenzimeve” nënkuptojmë rrogat dhe pagat, mallrat tjera dhe shërbimet, subvencionet dhe transferimet, shpenzimet e investimeve si dhe rezervat;

(dh) Me “shpenzime” nënkuptojmë pagesat e parave apo transferimet nga ose brenda Fondit të Konsoliduar të Kosovës;

(e) Me “qeveri” nënkuptojmë Kryeministrin dhe ministrat e Kosovës;

(ë) Me “Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës” nënkuptojmë buxhetin e gjithmbarshëm të Kosovës që përfshinë sektorët administrativë, komunalë dhe të ndërmarrjeve publike, të aktivitetit qeveritar të konsoliduar në përputhje me standardet e financave qeveritare të pranura ndërkombëtarisht;

(f) Me “Fondin e Konsoliduar të Kosovës” nënkuptojmë fondin e krijuar në përputhje me Rregulloren e ndryshuar të UNMIK-ut nr. 1999/16;

(g) Me “Sektorë të përgjithshëm të Buxhetit të Kosovës” nënkuptojmë sektorët e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës që përfshijnë sektorët e përgjithshëm, komunalë dhe publikë, të transaksioneve buxhetore të institucioneve të përkohshme të Kosovës (IPVK) dhe çdo organi apo agjencie të tyre, organet ose agjencitë e Administratës së Përkohshme të UNMIK-ut që i ushtrojnë funksionet e tyre nën autoritetin dhe përgjegjësitë e rezervuara për Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm në përputhje me kapitullin 8 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/9, çdo komunë e çdo organ apo agjenci të tyre dhe çfarëdo organi apo zyreje të theksuar në kapitullin 11 të Rregulores së UNMIK-ut nr. 2001/9;

(gj) Me “Sektorin e Buxhetit Komunal të Kosovës” nënkuptojmë atë sektor të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës që përfshin transaksionet buxhetore të administratave të themeluara komunale të Kosovës;

(h) Me “Pasqyrat e shpenzimeve dhe të hyrave të ndërmarrjeve publike të Kosovës” nënkuptojmë atë sektor të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës që përfshin shpenzimet dhe të hyrat e ndërmarrjeve të caktuara të Kosovës apo të grupeve të ndërmarrjeve dhe

(i) Me “tabela” nënkuptojmë tabelat e bashkëngjituara kësaj Rregulloreje.

Neni 2
Shpenzimet e përgjithshme

Shpenzimet autorizohen për periudhën prej 1 janarit deri më 31 dhjetor 2002 nga Sektori i Buxhetit të Përgjithshëm të Kosovës për qëllimet e përgjithshme shtetërore dhe shumat e paraqitura në tabelat 1 dhe 2, pjesa A e tabelës 3 dhe tabela 4. Lëshimi i fondeve për pagimin e shpenzimeve, siç është përcaktuar në tabelën 4 mund të autorizohet nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm pas njoftimit me shkrim të Udhëheqësit të Autoritetit Qendror Fiskal.

Neni 3
Shpenzimet komunale

Shpenzimet autorizohen për periudhën prej 1 janarit deri më 31 dhjetor 2002 nga Sektori i Buxheteve Komunale të Kosovës për qëllimet e përcaktuara dhe shumat e paraqitura në pjesën B të tabelës 3. Destinimet përkitazi me të hyrat autorizohen për aq sa të hyrat e përgjithshme të “burimeve mëvetësishme” depozitohen në Fondin e Konsoliduar të Kosovës siç është përcaktuar në pjesën B të tabelës 3 dhe destinimi regjistrohet në librin e llogarive të Autoritetit Qendror Fiskal. Shumat e autorizuar do të përdoren vetëm për qëllimet e përcaktuara dhe në përputhje me udhëheqjen e politikës së ministrisë përkatëse, agjencisë ekzekutive apo të nodnjë autoriteti tjetër të caktuar nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm .

Neni 4
Shpenzimet dhe të hyrat e ndërmarrjeve publike

Shpenzimet dhe të hyrat e parashikuara për periudhën prej 1 janarit deri më 31 dhjetor 2002 paraqiten në pasqyrat e shpenzimeve dhe të hyrave të ndërmarrjeve publike të Kosovës për qëllimet dhe shumat e paraqitura në tabelën nr. 5. Shpenzimet e parashikuara në tabelën nr. 3 autorizohen vetëm për aq sa realizohen të hyrat e çdo ndërmarrjeje, duke përfshirë të hyrat në formë të transferit të subvencionit të paraqitura në tabelën 1, 2 dhe 4. Çdo ndërmarrje e tillë i dorëzon Autoritetit Qendror Fiskal një pasqyrë mujore financiare, duke raportuar për të hyrat, shpenzimet dhe rrjedhën e parave të gatshme të subjektit përkatës, duke paraqitur çdo ndryshim në planin e përgjithshëm financiar siç është pasqyruar në tabelën 5.

Neni 5
Rindarja e detyrimeve financiare të pashpenzuara dhe bilancet

5.1 Pas mbylljes së vitit financiar 2000, udhëheqësi i Autoritetit Qendror Fiskal i dorëzon Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm për miratim një listë të detyrimeve të pashpenzuara financiare për vitin 2001 të regjistruara në librin e llogarive të Autoritetit Qendror Fiskal. Pas miratimit nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm, shpenzimet për detyrimet e tilla financiare do të konsiderohen të autorizuar për periudhën prej 1 janarit deri më 31 dhjetor 2002 nga Fondi i Konsoliduar i Kosovës.

5.2 Shpenzimet nga bilancet e pashpenzuara të subvencioneve të donatorëve të caktuar, të cilat në të vërtetë janë pranuar në vitin 1999, 2000 dhe 2001 autorizohen për periudhën prej 1 janarit deri më 31 dhjetor 2002.

5.3 Shpenzimet nga bilancet e pashpenzuara të subvencioneve të përgjithshme komunale për vitin 2001 autorizohen për periudhën prej 1 janarit deri më 31 dhjetor 2002. Shpenzimet nga bilancet e pashpenzuara për burimet e të hyrave të mëvetësishme për 2000 dhe 2001 autorizohen për periudhën prej 1 janarit deri më 31 dhjetor 2002 për atë që ato janë depozituar në Fondin e Konsoliduar të Kosovës dhe janë regjistruar në librin e llogarive të Autoritetit Qendror Fiskal.

Neni 6 Kufizimet në detyrime dhe shpenzime

6.1. Në përputhje me nenin 4.4 të Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut nr. 1999/16 nuk mund të bëhen kurrfarë shpenzimesh apo detyrimesh financiare nga Fondi i Konsoliduar i Kosovës ose në dëm të tij, pos autorizimeve të saktësuara me këtë Rregullore.

6.2 Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm, pas njoftimit me shkrim të udhëheqësit të Autoritetit Qendror Fiskal, mund të imponojë limite apo kufizime të tjera sa i përket mënyrës dhe shkallës me të cilën detyrimet duhet të paguhen.

6.3 Pavarësisht nga kufizimet e paraqitura në nenin 6.1 të kësaj Rregulloreje subvencionet e paparapara të donatorëve të depozituara në Fondin e Konsoliduar të Kosovës për qëllime të caktuara mund të ndahen dhe të shpenzohen për ato qëllime. Nëse qëllimi i specifikuar nuk është paraqitur ende në tabelë, një shumë e barasvlefshme me subvencionin e depozituar të donatorit konsiderohet se është ndarë dhe është krijuar një linjë buxhetore për të mundësuar realizimin e shpenzimit.

6.4 Të hyrat nga participimi dhe pagesat për qëllime të kujdesit shëndetësor të mbledhura nga Ministria e Shëndetësisë, Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në vitin 2002 do të ndahen për qëllime të kujdesit shëndetësor, pasi të hyrat depozitohen në Fondin e Konsoliduar të Kosovës dhe ndarja për këtë qëllim duhet të regjistrohet në librin e llogarive të Autoritetit Qendror të Kosovës.

6.5 Të hyrat nga participimi, taksat dhe pagesat e mbledhura nga komunat që tejkalojnë shumën e të hyrave të paraqitura në pjesën B të tabelës 3 do të ndahen pasi ndarja të depozitohet në Fondin e Konsoliduar të Kosovës dhe pasi destinimi të regjistrohet në librin e llogarive të Autoritetit Qendror Fiskal. Destimi i mjeteve për pagesat dhe shpenzimet e shkollimit apo të hyrat e participimi të kujdesit primar shëndetësor do të regjistrohen veçmas dhe do të përdoren nga komunat vetëm për arsim ose për qëllime të kujdesit primar shëndetësor.

6.6 Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të ndajë për qëllime të posaçme taksa apo pagesa të tjera të depozituara në Fondin e Konsoliduar të Kosovës dhe mund të autorizojë shpenzime në përputhje me atë ndarje. Një ndarje dhe autorizim i tillë sa i përket organeve apo agjencive të Administratës së Përkohshme të UNMIK-ut, që i ushtrojnë funksionet e tyre nën autoritetin dhe përgjegjësitë të rezervuara për Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm në përputhje me kapitullin 8 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/9 do të bëhet pas njoftimit me shkrim të udhëheqësit të Autoritetit Qendror Fiskal të Kosovës të dorëzuar përmes Këshillit Ekonomik dhe Fiskal. Një ndarje dhe autorizim i tillë sa i përket institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes dhe çfarëdo organi apo agjencie tjetër do të bëhet pas njoftimit me shkrim të drejtorit të Autoriteti Qendror Fiskal si dhe sekretarit të përhershëm të Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë të dorëzuar përmes Këshillit Ekonomik dhe Fiskal.

6.7 Institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes dhe të gjitha organet apo agjencitë e tyre, organet dhe agjencitë e Administratës së Përkohshme të UNMIK-ut që i ushtrojnë funksionet e tyre nën autoritetin dhe përgjegjësitë e rezervuara për Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm në përputhje me kapitullin 8 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/9, komunitet dhe të gjitha organet e agjencitë e tyre si dhe organet apo zyrtarët e pavarur të theksuara në Kapitullin 11 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/9, duhet të kenë kujdes që shpenzimet për rroga dhe paga të mos i tejkalojnë shumat e paraqitura në tabelat 1, 2 dhe 3 dhe numri i personelit në fund të vitit 2002 të mos e tejkalojë numrin e saktësuar në tabelat 1, 2 dhe 3.

6.8 Çdo propozim për rritjen e shpenzimeve për rroga dhe paga apo për rritjen e numrit të personelit mbi atë që është saktësuar në nenin 6.7 mund të miratohet vetëm nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm, duke vepruar në bazë të njoftimit me shkrim të Këshillit Ekonomik dhe Fiskal. Me rastin e shqyrtimit të propozimeve të një organi apo një agjencie të institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm e shqyrtojnë gjithashtu rekomandimin me shkrim të sekretarëve të përhershëm të Ministrisë së Shërbimeve Publike dhe të Minsitrisë së Financave dhe të Ekonomisë.

6.9 Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm, pas njoftimit me shkrim të udhëheqësit të Autoritetit Qendror Fiskal të dorëzuar përmes Këshillit Ekonomik dhe Fiskal, mund të bëjë ndryshime në tabela me anë të një urdhërese të mëvonshme administrative.

Neni 7 Shpenzimet e jashtëzakonshme

7.1 Shumat e autorizuar për shpenzimet e jashtëzakonshme mund të përdoren vetëm për kërkesat urgjente dhe të paparapara. Fondet e shpenzimeve të jashtëzakonshme ndahen në nënnyrën siç është përcaktuar në tabelën 1, si avans për Ministrin e Financave dhe të Ekonomisë, ndërsa në tabelën 2 si avans për Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm.

7.2 Për organet dhe agjencitë e institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes shumat mund të transferohen nga avansi në minsitrinë e Financave dhe të Ekonomisë. Sekretari i përhershëm i Ministrisë së Financave dhe i Ekonomisë mund të autorizojë, pas marrjes së arsyetimit adekuat, shpenzimin e shumave deri në 50.000 euro për çdo kërkesë urgjente dhe të paparaparë. Propozimet për transferimin e shumave mbi 50.000 euro dhe të tjerat që nuk i tejkalojnë 250.000 euro i përcillen bashkë me rekomandimin me shkrim të sekretarit të përhershëm të Financave dhe të Ekonomisë ministrit të Financave dhe të Ekonomisë për autorizim. Për shumat mbi 250.000 euro ministri i Financave dhe i Ekonomisë e konsulton qeverinë me rastin e marrjes së vendimit për autorizim.

7.3 Për shumat e ndara në tabelën 2 për kërkesa urgjente dhe të paparapara, drejtuesi i Autoritetit Qendror Fiskal mund të autorizojë, pas marrjes së arsyetimit adekuat, shpenzime deri në 50.000 euro për çdo kërkesë urgjente dhe të paparaparë të organeve dhe agjencive të Administratës së Përkohshme të UNMIK-ut, që i ushtrojnë funksionet e tyre nën autoritetin dhe përgjegjësitë e rezervuara për Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm në përputhje me kapitullin 8 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/9. Propozimet për transferimin e shumave të tilla mbi 50.000 euro i përcillen bashkë me rekomandimin adekuat të udhëheqësit të Autoritetit Qendror Fiskal Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm për autorizim.

7.4 Të gjitha transferimet e miratuara sipas nenit 7.2 të kësaj Rregulloreje i raportohen për çdo vit Kuvendit brenda tre muaj ditësh pas mbylljes së vitit financiar. Në rastet kur transferimet e tilla ngelin të pashpenzuara pas mbylljes së vitit financiar, ministri apo udhëheqësi i institucionit përkatës të vetëqeverisjes së përkohshme i bën një raport Kuvendit me një kopje që i dërgohet Këshillit Ekonomik dhe Fiskal. Për organet dhe agjencitë e administratës së përkohshme të UNMIK-ut që i ushtrojnë funksionet e tyre nën autoritetin dhe përgjegjësitë e rezervuara për Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm në përputhje me kapitullin 8 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/9, raportin e bën Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm me një kopje për Këshillin Ekonomik dhe Fiskal. Çështja si e tillë duhet të paraqitet në pasqyrat financiare përkatëse.

Neni 8

Përshtatja e shumave të autorizuara

8.1 Përshtatja e shumave të autorizuara mund të bëhet si vijon:

- (a) Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm, pas njoftimit me shkrim të udhëheqësit të Autoritetit Qendror Fiskal të dorëzuar përmes Këshillit Ekonomik dhe Fiskal, mund të bëjë transferime ndërmjet tabelave;
- (b) Për transferimet e autorizuara ndërmjet destinimeve për kategoritë e shpenzimeve të çfarëdo linjeje individuale buxhetore, me kusht që ajo rindarje të mos tejkalojë në total njëzet për qind (20%) të kategorisë që zvogëlohet dhe një transferim i tillë mund të bëhet pas njoftimit me shkrim të:
 - (i) Sekretarit të përhershëm të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për tabelën 1 dhe
 - (ii) Udhëheqësit të Autoritetit Qendror Fiskal, për tabelat 2, 3 dhe 4.
- (c) Transferimet e shumave të autorizuara ndërmjet destinimeve të kategorive të shpenzimeve për çfarëdo linje individuale buxhetore mbi njëzet për qind (20%) të kategorisë që zvogëlohet, duke përfshirë transferimet ndërmjet linjave buxhetore, mund të bëhen pas miratimit me shkrim të:
 - (i) Ministrit të Financave dhe të Ekonomisë për tabelën 1 pas njoftimit me shkrim të sekretarit të përhershëm të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë e qeverisë. Njoftimi për vendime të tilla i jepet me shkrim kryetarit të Komisionit të Buxhetit të Kuvendit jo më vonë se katërmëdhjetë (14) ditë pas vendimit dhe
 - (ii) Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm për tabelat 2, 3 dhe 4 pas njoftimit me shkrim të udhëheqësit të Autoritetit Qendror Fiskal;
- (ç) Destinimet për rezerva mund të transferohen pjesërisht ose në tërësi në cilëndo kategori brenda të njëjtit funksion dhe tabelë pas miratimit me shkrim të udhëheqësit të Autoritetit Qendror Fiskal (tabelat 2, 3 dhe 4) apo të sekretarit të përhershëm të Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë (tabela 1) dhe
- (d) Shumat e autorizuara në përputhje me nenin 7 të kësaj Rregulloreje mund të transferohen ndërmjet linjeve buxhetore në tabelën 1 nga sekretari i përhershëm i Ministrisë së

Financave dhe Ekonomisë, ndërsa në tabelat 2, 3 e 4 nga udhëheqësi i Autoritetit Qendror Fiskal.

8.2. Udhëheqësi i Autoritetit Qendror Fiskal njoftohet për të gjitha përshtatjet e shumave të autorizuar me shkrim dhe në mënyrën e cila do të përcaktohet nga udhëheqësi i Autoritetit Qendror Fiskal me një udhëzim administrativ vijues për të regjistrim në librin e llogarive të Autoritetit Qendror Fiskal.

Neni 9 Shpenzimet e kufizuara në të hyra

Udhëheqësi i Autoritetit Qendror Fiskal, me rastin e ndarjes së fondeve për shpenzime i ndan vetëm ato mjete financiare me kusht që të hyrat apo burimet tjera financiare të jenë në dispozicion të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës për t'i bërë ato shpenzime.

Neni 10 Raportimi vjetor

10.1. Brenda tre (3) muaj ditësh pas mbylljes së vitit financiar, sekretari i përhershëm i Ministrisë së Financave dhe i Ekonomisë, pas marrjes nga thesari të një pasqyre për detyrmet dhe shpenzimet institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes, e përgatit një raport për këtë çështje dhe ia dorëzon atë ministrit të Financave dhe të Ekonomisë. Pas konsultimit me Kryeministrin, ministri pastaj ia përcjell atë drejtorit të Komisionit të Buxhetit të Kuvendit, me kopje edhe për Këshillin Ekonomik dhe Fiskal dhe udhëheqësin e Autoritetit Qendror Fiskal.

10.2 Pas marrjes së raportit të bërë në përputhje me nenin 10.1 të kësaj Rregulloreje, udhëheqësi i Autoritetit Qendror Fiskal, brenda afatit prej katër (4) muaj ditësh pas mbylljes së vitit financiar, ia paraqet Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm dhe Këshillit Ekonomik dhe Fiskal një raport të konsoliduar të detyrimeve dhe shpenzimeve të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës.

Neni 11 Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 22 dhjetor 2001.

Bernard Kouchner,
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm